R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1389/4 prot. Tiranë, më 04.9.2026

V E N D I M

Nr.35, datë 04.9.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Znj. , gazetare pranë Rrjetit për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri (në vijim "ankuesja"), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") formularin e ankesës nr. 1389 prot., datë 21.05.2026, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesja, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 23.04.2026, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni për periudhën kohore 2015 – 2026, në lidhje me:

1. *Të gjitha vendimet e qeverisë dhe ministrisë që lidhen me miratimin për ndërtimin e parqeve fotovoltaike dhe eolike më Shqipëri.*
2. *Një kopje të të gjitha lejeve dhe kontratave të dhëna për parqet fotovoltaike dhe eolike, përfshirë:*
   - *emrin e projektit dhe kompanisë/investitorit përkatës;*
   - *vendndodhjen (qark, bashki, fshat dhe parcela e tokës/nr. pasurie);*
   - *kapacitetin e autorizuar (MW);*
   - *datën e miratimit dhe statusin aktual të projektit.*
3. *Raportet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit lidhur me vlerësimin e ndikimit mjedisor për këto projekte.*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesja i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, me shkresën nr. 1389/1 prot., datë 26.05.2026, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke vlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 02.06.2026.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 4589/1 prot., datë 30.06.2026, ka kthyer përgjigje, duke sqaruar se: *"Informacioni i kërkuar në pikën e parë mbi të gjitha vendimet e qeverisë dhe ministrisë që lidhen me miratimin për ndërtimin e parqeve fotovoltaike dhe eolike në Shqipëri është i publikuar dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare (QBZ), në adresën: https://qbz.gov.al/. Në lidhje me kërkesën e dytë mbi kopjet e të gjitha lejeve dhe kontratave të dhëna për parqet fotovoltaike dhe eolike, ju informojmë se për sigurimin e këtij informacioni mund t'i drejtoheni Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), e cila, në zbatim të VKM-së nr. 547, datë 09.08.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", i ndryshuar, sipas pikës 3, ushtron ndër të tjera kompetencën për monitorimin e kontratave koncesionare ose jo, për centralet prodhuese nga burime të rinovueshme. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se objekti i kërkesës për raportet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis për këto projekte nuk është në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë".*

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI-së, në të cilin parashikohet se: "*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", bazuar edhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri çmoi të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore, e cila u mbajt më 09.07.2026, me praninë e përfaqësuesve të Autoritetit Publik dhe ankueses.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesën fillestare, si dhe vijimin e saj përmes depozitimit të parashtrimeve ku, ndër të tjera, është shprehur se: *"...Refuzimi i dhënies së informacionit nga ana e autoritetit publik është i pabazuar në ligj. Së pari: Informacioni i kërkuar bën pjesë në kategorinë e informacionit*

i cili vihet në dispozicion pa kërkesë. Në nenin 2, pika 2, të ligjit "Për të drejtën e informimit" parashikohet se: "Informacion publik" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik". Informacioni i kërkuar është një e dhënë e cila disponohet nga ministria, si institucion i cili është prodhues dhe mbajtës i dokumentacionit. Së dyti: Në lidhje me referimin në faqen zyrtare të QBZ-së, ligji "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, në nenin 16, pika 2, parashikon: "2. Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni. Kur informacioni nuk kërkohet në format elektronik, autoriteti publik nuk mund t'i përgjigjet kërkesës, duke i treguar kërkuesit adresën e saktë të faqes ku informacioni gjendet në formë elektronike". Në rast se autoriteti publik pretendon se informacioni i kërkuar nga ana jonë gjendet i publikuar në internet, sipas parashikimeve ligjore, duhet të vërë në dispozicion linkun e saktë ku mund të aksesohet informacioni dhe jo të referojë faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare (QBZ). Së treti: Në lidhje me kopjen e të gjitha lejeve dhe kontratave të dhëna për parqet fotovoltaike dhe eolike (pika dy e kërkesës), AKBN është përgjegjëse për monitorimin e zbatimin të kontratave, por pjesë kontraktuese në këto kontrata është ministria, pra në rastin konkret autoriteti publik e disponon informacionin. Së katërti: Sa i takon pikës së tretë "Raportet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit lidhur me vlerësimin e ndikimit mjedisor për këto projekte", në rastin konkret, nëse nga ana e autoritetit publik konstatohet se nuk e disponon informacionin as si prodhues dhe as si mbajtës i tij, por kompetent është një autoritet tjetër, sipas ligjit duhet t'ia dërgojë për kompetencë autoritetit përkatës brenda 10 ditëve, duke vënë në dijeni edhe kërkuesin, proces i cili nuk është zbatuar në rastin konkret. Neni 12, pika 2 e ligjit "Për të drejtën e informimit" 2. Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar". Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në aktet shkresore të sipërcituara.

Në vijim të diskutimit të palëve gjatë seancës dhe referencave ligjore të cituara nga drejtuesi i seancës, përfaqësuesve të Autoritetit Publik iu la kohë në dispozicion për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur ndaj kërkesës për informacion. Pas seancës dëgjimore, Autoriteti Publik, me *e-mail*-in e datës 09.07.2026, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrisë së Mjedisit, duke i kërkuar dërgimin e informacionit brenda datës 20.07.2026. Deri në datën e marrjes së këtij vendimi, Autoriteti Publik nuk ka kthyer përgjigje.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI-së.

Në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: *""Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj".* Në kuptim të këtij parashikimi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1, përcakton se: *"1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike".*

Në interpretim të kombinuar të këtyre dispozitave, rezulton se qëllimi i ligjvënësit është garantimi i njohjes me informacionin publik të çdo personi të interesuar, duke vendosur mbi autoritetet publike detyrimin për të trajtuar kërkesat për informacion dhe për të mundësuar marrjen e informacionit që ato prodhojnë ose zotërojnë. Ky detyrim nuk përmbushet vetëm nëpërmjet një përgjigjeje formale ndaj kërkuesit, por kërkon që Autoriteti Publik të kryejë verifikimet e nevojshme dhe të japë një përgjigje konkrete, të plotë dhe të argumentuar për secilën pikë të kërkesës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së ankimit rezulton se Autoriteti Publik nuk ka dhënë një përgjigje të plotë dhe konkrete ndaj kërkesës së ankueses, por është kufizuar në orientimin e saj drejt burimeve apo autoriteteve të tjera publike. Ky qëndrim nuk përmbush kërkesat e LDI-së, veçanërisht për sa i përket detyrimit të Autoritetit Publik për të identifikuar informacionin që prodhon ose mban dhe për ta vënë atë në dispozicion të kërkueses, në formatin e kërkuar. Nisur nga objekti i kërkimit, bëhet fjalë për informacion që lidhet me veprimtarinë administrative dhe vendimmarrëse të autoriteteve publike dhe, si rrjedhojë, i nënshtrohet regjimit të aksesit sipas LDI-së, duke mbajtur në konsideratë kufizimet e parashikuara në nenin 17 të tij.

Lidhur me pikën e parë të kërkesës për informacion, *mbi të gjitha vendimet e qeverisë dhe ministrisë që lidhen me miratimin për ndërtimin e parqeve fotovoltaike dhe eolike në Shqipëri*, Autoriteti Publik ka pretenduar se informacioni është i publikuar dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare, në linkun *https://qbz.gov.al/*. Komisioneri vlerëson se referimi në një burim të përgjithshëm publik nuk mund të konsiderohet në vetvete përmbushje e detyrimit për informim nëse Autoriteti Publik nuk identifikon dhe nuk i tregon kërkuesit burimin konkret ku gjendet informacioni i kërkuar, në përputhje me kërkesat e pikës 2 të nenit 16 të LDI-së, e cila parashikon se: *"2. Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni".* Qëllimi i kësaj dispozite është t'i mundësojë kërkuesit akses të

drejtpërdrejtë në informacionin e kërkuar dhe jo thjesht ta orientojë atë drejt një burimi të përgjithshëm publik, ku identifikimi i dokumentacionit i lihet kërkuesit. Ankesa synon marrjen e një tërësie dokumentesh të identifikueshme, që lidhen me një periudhë të caktuar kohore, përkatësisht vitet 2015 – 2026.

Sa i përket pikës së dytë të kërkesës, që konsiston në vënien në dispozicion *të kopjeve të lejeve dhe kontratave të dhëna për parqet fotovoltaike dhe eolike*, së bashku me të dhënat identifikuese të projekteve dhe investitorëve, Komisioneri vlerëson se përgjigjja e Autoritetit Publik nuk është e mjaftueshme për të përmbushur detyrimin ligjor për informim. Fakti që Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ushtron funksione lidhur me monitorimin e kontratave, nuk provon, në vetvete, se Autoriteti Publik nuk prodhon ose nuk disponon dokumentacionin e kërkuar. Përkundrazi, nga vetë natyra e marrëdhënieve juridike dhe institucionale të përmendura nga palët, rezulton se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka rol në procedurat e miratimit, autorizimit dhe/ose lidhjes së kontratave përkatëse, çka nënkupton se Autoriteti Publik e disponon dokumentacion e kërkuar, fakt ky i provuar edhe gjatë seancës dëgjimore.

Në këtë pikë, Komisioneri çmon të nevojshëm të theksojë se detyrimi për të dhënë informacion nuk mund të shmanget vetëm për shkak se i njëjti informacion mund të gjendet apo të administrohet edhe nga një autoritet tjetër publik. Për sa kohë Autoriteti Publik e prodhon ose e zotëron informacionin e kërkuar, ai mbetet i detyruar të shqyrtojë kërkesën dhe të vërë në dispozicion dokumentacionin përkatës, në përputhje me dispozitat e LDI-së.

Në lidhje me pikën e tretë të kërkesës, ku kërkohen *raportet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve* objekt kërkimi, Autoriteti Publik ka deklaruar fillimisht se kjo çështje nuk është në fushën e përgjegjësisë së tij. Megjithatë, gjatë seancës dëgjimore, Autoriteti Publik u shpreh se dokumentacioni disponohet, por për shkak së kërkimi përfshin një periudhë të gjatë kohore, është vështirë për t'u identifikuar dhe vënë në dispozicion. Me qëllim lehtësimin dhe përshpejtimin e procedurës, duke pasur dakordësinë e ankueses, pas seancës dëgjimore Autoriteti Publik i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrisë së Mjedisit, duke i kërkuar dërgimin e informacionit brenda një afati të caktuar. Deri në datën e marrjes së këtij vendimi, Autoriteti Publik nuk rezulton ta ketë informuar ankuesen mbi rezultatin e këtij veprimi dhe as t'i ketë vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar. Për rrjedhojë, vetëm dërgimi i një kërkese pranë një autoriteti tjetër publik nuk mund të konsiderohet përmbushje e së drejtës së ankueses për informim, kur vetë Autoriteti Publik u shpreh se pas marrjes së dokumentacionit do t'ia vinte në dispozicion ankueses.

Në këto kushte, vlen të theksohet se për nga natyra e informacionit të kërkuar, dokumentacioni që lidhet me vlerësimin e ndikimit në mjedis përbën dokumentacion të krijuar dhe administruar në kuadër të procedurave administrative për miratimin, autorizimin dhe zhvillimin e projekteve energjetike, objekt i kërkesës për informacion, dhe rrjedhimisht disponohet nga Autoriteti Publik. Veprimi i ndërmarrë nga Autoriteti Publik, duke kaluar kërkesën për informacion pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përbën një veprim të ndërmarrë për sigurimin dhe plotësimin e informacionit dhe jo një

delegim të kërkesës, në kuptim të pikës 2 të nenit 12 të LDI-së, e cila parashikon se: *"2. Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar".* Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kalimi i kërkesës për informacion nga Autoriteti Publik drejtuar autoriteteve të tjera për të siguruar dokumentacionin përkatës nuk e përjashton dhe as nuk e shuan detyrimin e tij për të trajtuar kërkesën fillestare në përputhje me kërkesat e LDI-së. Përkundrazi, përgjegjësia për trajtimin e kërkesës dhe dhënien e informacionit ankueses mbetet pranë Autoritetit Publik, pavarësisht komunikimeve apo kërkesave të brendshme ndërinstitucionale të ndërmarra për sigurimin e dokumentacionit.

Në përfundim të vlerësimit të kësaj çështjeje, Komisioneri mban në konsideratë edhe parimin e transparencës së autoriteteve publike dhe interesin e publikut për t'u njohur me informacionin që lidhet me administrimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, autorizimin dhe zhvillimin e projekteve energjetike, si dhe ndikimin e tyre në mjedis. Këto të dhëna lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e funksioneve publike dhe veprimtarinë e autoriteteve publike.

Në këto kushte, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të LDI-së, i cili përcakton se: *""Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik."* Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, duke mbajtur në konsideratë pikën 6 të nenit 17 të LDI-së, sipas të cilit parashikohet se: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".*

Për sa më sipër, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër joshtetëror, që ushtron funksione publike. Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI-së: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si elemente themelore të shtetit të së drejtës.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, si dhe shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankesës nr. 1389 prot., datë 21.05.2026, të znj. , kundër Autoritetit Publik "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 23.04.2026, konkretisht: *1. Të gjitha vendimet e qeverisë dhe ministrisë që lidhen me miratimin për ndërtimin e parqeve fotovoltaike dhe eolike më Shqipëri. 2. Një kopje të të gjitha lejeve dhe kontratave të dhëna për parqet fotovoltaike dhe eolike, përfshirë: emrin e projektit dhe kompanisë/investitorit përkatës; vendndodhjen (qark, bashki, fshat dhe parcela e tokës/nr. pasurie); kapacitetin e autorizuar (MW); datën e miratimit dhe statusin aktual të projektit; 3. raportet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit lidhur me vlerësimin e ndikimit mjedisor për këto projekte*, duke respektuar sipas rastit kufizimet e parashikuara në nenin 17 të LDI-së dhe detyrimin për akses të pjesshëm sipas pikës 6 të këtij neni, brenda datës 15.9.2026.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

4. Ky vendim u shpall sot, më datë 04.9.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi